



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

Nr. 7638 Prot.

Tiranë, më 16.07.2018

URDHËR

NR. 422, DATË 16.07.2018

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMIT "BACHELOR"  
NË "TEKNIK LABORATORI NË MJEKËSI" NË KOLEGJIN UNIVERSITAR  
"REALD"**


Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 18, 23, 35, 69, 72 dhe 73 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të ciklit të parë të studimit "Bachelor" në "Teknik laborator në mjekësi", që realizohet me 180 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Bachelor" në "Teknik laborator në mjekësi", në Fakultetin e Shkencave Mjeksësore, të Kolegjit Universitar "Reald", referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e ciklit të parë të studimit "Bachelor" në "Teknik laborator në mjekësi", fillon në vitin akademik 2018-2019.
3. Kolegji Universitar "Reald", të plotësojë rekomandimet e ekspertit dhe t'i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë program studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin "Kolegji Universitar "Reald".

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar "Reald".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

~~MINISTËR~~  
  
**Lindita Nikolla**

